

VENDIM
Nr.462, datë 5.7.2006

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE, ZNJ.LINDITA ÇALA, PËR STREHIMIN E FAMILJES SË SAJ, NËPËRMJET ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, të pikave 1 e 2 të nenit 4 të ligjit nr.9416, datë 20.5.2005 “Për procedurat e privatizimit të banesave të ndërtuara ose të blera me fondet shtetërore nga Enti Kombëtar i Banesave” dhe të ligjit nr.9464, 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien zonjës Lindita Çala të ndihmës financiare, në shumën 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, për lindjen e katërnjakëve dhe për strehimin e familjes së saj, në një banesë, të blerë në tregun e lirë, në qytetin e Tiranës, sipas procedurave të Entit Kombëtar të Banesave.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të vërë në dispozicion të Entit Kombëtar të Banesave shumën prej 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) lekësh, nga fondet për strehim, e cila të shlyhet nga përfituesja, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.9416, datë 20.5.2005 “Për procedurat e privatizimit të banesave të ndërtuara ose të blera me fondet shtetërore nga Enti Kombëtar i Banesave”.

4. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha